



Програма „Форуми  
во заедницата“

Community  
Forums Programme

Programi  
“Forume në bashkësinë”

# PROGRAMI „FORUME NË BASHKËSINË“



INTERVISTË ME  
KRYETARIN E KOMUNËS SË STUDENIÇANIT

„FORUMI DO TË BËHET PRAKTIKË  
GJATË PLANIFIKIMIT TË BUXHETIT,“

FORUMI SIPAS SESIONEVE

PARALAJMËROHET CIKËL I  
RI PËR CERTIFIKATA TË  
MODERATORËVE

KOMUNAT SHKËMBYEN  
PËRVOJA NGA PROCESI BUXHETOR





# FORUMI DO TË BËHET PRAKTIKË GJATË PLANIFIKIMIT TË BUXHETIT

**1. Komuna e Studeniçanit për herë të parë e realizon procesin e forumit buxhetor. Cilat janë përvojat Tuaja të para nga mbajtja e forumit?**

Komuna jonë për herë të parë e mban forumin buxhetor. Më parë, kemi realizuar forum projektues prej të cilit forum ka rezultuar një projekt shumë i rëndësishëm për qytetarët e Komunës së Studeniçanit. Mund të them se përvojat e para janë shumë pozitive pasi që qytetarët, për herë të parë, në mënyrë të drejtëpërdrejtë informohen në lidhje me buxhetin e komunës. Me këtë rast, përveç asaj se në mënyrë të detajuar u informuan për të hyrat dhe shpenzimet e buxhetit komunal ata kishin hapësirë që të japin propozimet e tyre në lidhje me buxhetin e komunës.

**2. A Ju ndihmoi forumi buxhetor në përcaktimin e**

**prioriteteve strategjike dhe zhvillimore të komunës?**

Gjithsesi se na ka ndihmuar në përcaktimin e prioriteteve të programeve zhvillimore dhe në përgjithësi strategjisë së komunës. Pasi që qytetarët me propozimet e tyre drejtëpërdrejtë u kyçën në përcaktimin e strategjisë së komunës dhe programeve zhvillimore të buxhetit komunal ishte më lehtë për komunën që të definohej këto prioritete.

**3. A është dhe sa është i gatshëm pushteti lokal që në mënyrë transparente dhe llogaridhënese t'u përgjigjet kërkesave të qytetarëve?**

Ne si komunë gjithmonë kemi bërë përpjekje që të jemi transparent dhe qytetarët t'i kyçim në vendimmarrjen për projekte dhe aktivitete që kanë të bëjnë me nevojat e tyre. Jo formalisht edhe para se të organizojmë forume buxhetore gjithmonë jemi munduar që të marrim mendimin e qytetarëve në takimet që kemi realizuar. Gjithashtu, qëllimi ishte që t'u japim raport për punën që e bëjmë. Megjithatë, me organizimin e forumeve përfituam një përvojë të veçantë e cila ishte mjaftë e frytshme edhe në të ardhmen shpresojmë se, ky lloj i organizimit të forumeve, të bëhet tashmë praktikë e komunës tonë.

**„Mund të them se përvojat e para janë shumë pozitive pasi që qytetarët, për herë të parë, në mënyrë të drejtëpërdrejtë informohen në lidhje me buxhetin e komunës“, deklaroi kryetari i Komunës së Studeniçanit, z.Sadiki**





# FORUMI SIPAS SESIONEVE

**Procesi i forumit buxhetor në 10 komunat që u zgjodhën në kuadër të fazës së re të programit “Forume në bashkësinë”, gjatë muajve dhjetor, janar dhe shkurt, vazhdoi aktivitetet e veta. Dy komuna (Kavadari dhe Studeniçani) mbajtën tre sesione të forumit (sesionin e 3-të, 4-ët dhe 5-të), shtatë komuna (Novaci, Kriva Pallankë, Ilinden, Kërçovë, Strumicë, Radovish dhe Gostivar) mbajtën dy sesione të forumit (sesionin e 4-ët dhe 5-të), ndërsa një komunë (Mavrovë dhe Rostushë) mbajti një sesion të forumit (5-të).**

## Programi ZHLE – parësor për banorët e Kavadarit



Komuna e Kavadarit, në dhjetor të vitit të kaluar, mbajti tre sesione të forumit, më 1, 5 dhe 16 dhjetor, në kuadër të të cilave u diskutua për pesë programe buxhetore – Infrastruktura rrugore, Planifikim urbanistik, ZHLE, Arsim dhe Kulturë. Sesionet, që i ndoqën mesatarisht rreth 70 pjesëmarrës, përcaktuan rreth 30 propozime të qytetarëve lidhur me atë se si të shpenzohen mjetet buxhetore të komunës. Forumi i prezantoi edhe propozimet e qytetarëve për të ardhura në buxhetin komunal që i shqyrtoi grupi punuese ndërmjet sesioneve të forumit, ndërsa u bë edhe një pasqyrë e shpenzimeve të planifikuara dhe realizuara të komunës për dy vitet paraprake, si dhe për vitin 2015. Në sesionin e pestë të forumit, në të cilin radhiteshin programe buxhetore dhe përcaktoheshin si prioritete projektet në kuadër të buxhetit, u përcaktua projekti për formimin e Byrosë turistike informative si prioritet.

## Banorët e Studeniçanit votuan për programin Rrugë dhe udhë

Forumit në Studeniçan, gjatë kësaj periudhe, mbajti tre sesione të forumit (1, 5 dhe 12 dhjetor) ku me pjesëmarrjen e mesatarisht 70 banorëve të komunës, u zgjodhën programe dhe projekte parësore buxhetore.



Pjesëmarrësit e sesioneve të forumit diskutuan për tre programe buxhetore – Veprimtari komunale, Ndërtim, riparim dhe mirëmbajtje të rrugëve lokale dhe Urbanizëm, ndërsa Forumi përcaktoi si prioritete 22 projekte për realizim nga administrata komunale, ndërmjet të cilëve janë përfshirë edhe propozimet e qytetarëve që janë dhënë në procesin e forumit.

## Banorët e Novacit përcaktuan 24 projekte si prioritete në buxhetin për vitin 2015

Komuna e Novacit, gjatë sesionit të pestë të forumit që u mbajt më

15 dhjetor të vitit të kaluar, i përcaktoi projektet dhe programet parësore pasi që paraprakisht, më 1 dhjetor, rreth 70 banorë diskutuan për katër programe buxhetore.



Forumit, në sesionin e katërt, i shqyrtoi programet për Kulturë, për Sport dhe rekreacion, për Ndërtim dhe rekonstrukcion të rrugëve lokale dhe për Ndryshim rrugor të komunës. Pjesëmarrësit dhanë rreth 30 propozime me qëllim të përmirësimit të shpenzimit të mjeteve buxhetore me ç’rast numri më i madh i propozimeve ishin për programin Ndërtim dhe Rikonstrukcion të rrugëve lokale.

Gjatë sesionit të pestë të forumit, forumi përcaktoi si prioritete 24 projekte prej tetë programeve buxhetore që vetëqeverisja lokale do t’i planifikojë në buxhetin për vitin 2015.

Forumit i përcaktoi prioritetet në fushat e infrastrukturës lokale gjegjësisht ndërtim të rrugëve, sisteme ujësjellësi, sisteme të kanalizimit, si dhe projekte tjera më të vogla.

## Kriva Pallanka përcaktoi si prioritete 30 projekte

Forumit në Kriva Pallankë, në dy sesionet e forumit që i mbajti në dhjetor të vitit të kaluar, diskutoi në tre programe buxhetore dhe përcaktoi si prioritete 30 projekte. Sesioni i pestë i forumit, që u mbajt më 11 dhjetor në prani të 75 pjesëmarrësve, si dhe sesioni i katërt i forumit që u mbajt më 2 dhjetor, në prani të 71 banorëve,

kishin të bëjnë me diskutime për shpenzimet buxhetore prej tre programeve buxhetore – Programi për planifikim urbanistik, për Mbrojtje sociale dhe për Zhvillim lokal ekonomik, si dhe për përcaktimin si prioritete të 30 projekteve dhe radhitjen e programeve buxhetore.



Pjesëmarrësit nga secila tavolinë punuese jepën nga 20 propozime sipas programit buxhetor ndaras me qëllim të përmirësimit të shpenzimit të mjeteve buxhetore. Projekti për ndërtimin e rrjetit të kanalizimit në aksin Qendra për kulturë deri te lagjja Manevci, është përzgjedhur si më parësor, ndërsa programet për Planifikim urbanistik, për Rregullimin e truallit ndërtimor dhe për Zhvillim lokal ekonomik fituan mbështetjen më të madhe gjatë përcaktimit të prioriteteve sipas tavolinave të punës.

### **Projekte prej më shumë fushave – prioritete për banorët e llindenit**

Disa projekte nga fusha e infrastrukturës rrugore, arsimit, mbrojtjes së mjedisit jetësor, rregullimit të truallit ndërtimor, urbanizimit, pastërtisë publike dhe ndriçimit publik, sportit dhe kulturës, i potencuan banorët e Komunës së llindenit si parësore që duhet të hyjnë në buxhetin e Komunës së llindenit për vitin 2015.

Ky është rezultati nga sesioni i pestë i forumit që në kuadër të programit “Forume në bashkësinë” u mbajt më 17 dhjetor, ku qytetarët votuan sipas 26 projekteve të parapërzgjedhura që

ishin propozuar dhe përzgjedhur nga grupet punuese.



Forumi, në sesionin e katërt të forumit që u mbajt më 4 dhjetor, diskutoi për katër programe buxhetore në prani të 134 banorëve të komunës. Ky sesion i shqyrtoi shpenzimet e planifikuara të programeve Urbanizëm, Infrastrukturë rrugore, Rregullim të truallit ndërtimor dhe për Arsim, ndërsa për secilin prej programeve qytetarët dhënë propozimet e veta.

### **Forumi në Strumicë përcaktoi si prioritete 30 projekte**



Komuna e Strumicës mbajti dy sesione të forumit – më 4 dhe 12 dhjetor, vitin e kaluar, në prani të 100 banorëve të komunës. Përfaqësues të vetëqeverisjes lokale, duke përfshirë edhe kryetarin e komunës, i prezantuan dhe arsyetuan shpenzimet buxhetore në pajtim me shtatë programe zhvillimore për vitin 2015 në procesin e planifikimit të buxhetit komunal. Forumi diskutoi edhe në pajtim me propozimet konkrete të qytetarëve për projekte nga fusha e vetëqeverisjes lokale, manifestime dhe krijimtari kulturore, program social, arsim, zhvillim lokal ekonomik dhe mbështetje të sektorit OJQ, mbrojtje të mjedisit jetësor dhe sport e rekreacion.

Pjesëmarrësit në sesionet i votuan prioritetet në kuadër të programeve dhe projekteve buxhetore Ndërtim të sistemeve për kanalizim dhe pastrim të ujërave të pista, ndërsa përcaktuan si prioritete 30 projekte për realizim në kuadër të buxhetit komunal për vitin e ardhshëm.

### **Programi për veprimtari komunale – prioritete për banorët e Radovishit**

Forumi në Komunën e Radovishit, në këtë periudhë, mbajti dy sesione të forumit (10 dhe 18 dhjetor), në prani të 105, gjegjësisht 46 pjesëmarrësve.

Banorët e kësaj komune, në sesionin e katërt të forumit, i shqyrtorin shpenzimet e planifikuara të programeve Veprimtari komunale, Urbanizëm, Mbrojtje të mjedisit jetësor dhe për Arsim, ndërsa për secilin prej programeve qytetarët dhanë rreth 20 propozime të veta.



Pjesëmarrësit e sesionit të pestë të forumit e përzgjedhën Programin buxhetor për veprimtari komunale si parësore në realizimin për vitin 2015, prej gjithsej 8 programeve buxhetore sa ishin hedhur për votim. Forumi përcaktoi 20 projekte si prioritete për realizim nga autoritetet komunale për sivjet, në mesin e të cilave janë përfshirë edhe propozimet e qytetarëve nga procesi i forumit.

### **Programi për arsim – prioritete për qytetarët e Komunës së Gostivarit**

Gjithsej dy sesione të forumit mbajti Komuna e Gostivarit në



kuadër të procesit të forumit buxhetor – më 10 dhe 18 dhjetor, në prani të 70 pjesëmarrësve.

Programi buxhetor për arsim ishte votuar si prioritet për qytetarët e Komunës së Gostivarit, prej gjithsej 12 programeve zhvillimore sa ishin radhitur në sesionin e pestë të forumit, derisa 31 projekte ishin përcaktuar si prioritet në përputhje me kërkesat e banorëve.

Paraprakisht në sesionin e katërt të forumit, qytetarët diskutuan për tre programe buxhetore – për Kulturë, për të Rinj, sport dhe rekreacion dhe për Mbrojtje sociale, ndërsa pjesëmarrësit dhanë rreth 59 propozime për atë se si të shpenzohen mjetet buxhetore në pajtim me nevojat e qytetarëve për çdo program buxhetor ndaras.



Ndryshe, projekti “Ndërtim të kanalizimit fekale në disa vendbanime dhe vazhdim i kanalizimit në vendbanimin Çajle”, u votua si parësor për realizim në vitin 2015.

### **Forumi në Mavrovë Rostushë votoi për programe dhe projekte**



Programe dhe projekte parësore buxhetore për vitin 2015 votoi forumi në Mavrovë Rostushë në sesionin e pestë të forumit që u mbajt më 4 dhjetor, në prani të 56 banorëve të kësaj komune. Pjesëmarrësit e forumit e përcaktuan programin buxhetor Riparime dhe mirëmbajtje të rrugëve lokale të jetë prioritet për vetëqeverisjen lokale për vitin e ardhshëm 2015, prej gjithsej 11 programeve buxhetore që u hodhën për votim. Gjithsej 18 projekte në kuadër të programeve buxhetore që autoritetet komunale i pranuan për realizim për vitin 2015 ishin përcaktuar si prioritet në pajtim me nevojat e banorëve të kësaj komune.

### **Sesion vijues në Bogovinë dhe Bërvenicë**

Sesioni i gjashtë, vijues i forumit nga forumi ndërmjet komunave në Bogovinë dhe Bërvenicë, u mbajt më 19 dhjetor, të vitit të kaluar, në Bogovinë në prani të 72 pjesëmarrësve të dy komunave.



Në forumin u prezantuan rezultatet nga projekti “Rikonstrukcion dhe rehabilitim të rrugës Zherovjan-Radiovcë”, që u realizua për disa muaj. Me realizimin e projektit u ndërtuan 1950 metra rrugë me çka u rrit siguria në komunikacion dhe u krijuan kushtet e domosdoshme për zhvillim lokal ekonomik dhe bashkëpunim ndërmjet dy komunave. Kryetarët e të dyja

komunave, z. Hazbi Idrizi nga Bogovina dhe z. Enver Pajaziti nga Bërvenica, edhe një herë e theksuan rëndësinë e pjesëmarrjes së qytetarëve në përcaktimin e prioritetëve lokale dhe realizimin e tyre.

### **Programet Arsim dhe Rrugë e trotuare – më parësore për Kërçovën**

Forumi në Kërçovë, në dhjetor, mbajti dy sesione të forumit – më 4 dhe 11 dhjetor, në prani të 68, gjegjësisht 72 banorëve të kësaj komune.



Programet buxhetore Arsim dhe Rrugë e trotuare janë përzgjedhur si më parësore gjatë realizimit të buxhetit për vitin 2015, ndërsa 34 projekte në kuadër të tetë programeve buxhetore janë përcaktuar si prioritet për realizim gjatë vitit të ardhshëm. Banorët e kësaj komune votuan për projektet Ndërtim të rrjetit të kanalizimit në fshatin Zajaz Ukaj, rrethoja, parkingje, vende të posaçme për autobusët shkollorë dhe ndriçim përkatës të shkollat. Ndërtim të ujësjellësit në fshatin Kollarë, etj. Paraprakisht, në sesionin e katërt të forumit, qytetarët diskutuan për shpenzimet e planifikuara të programeve për Rrugë dhe trotuare, për Sport dhe kulturë, për Punë sociale dhe për Zhvillim lokal ekonomik, ndërsa për secilin prej programeve qytetarët dhanë 10 propozime të veta.

## PARALAJMËROHET CIKËL I RI PËR CERTIFIKIMIN E MODERATORËVE



**Takim koordinues me 27 moderatorë të certifikuar për përvojat nga shfrytëzimi i instrumentit për pjesëmarrje qytetare në marrjen e vendimeve “forume në bashkësinë” në komunat, u mbajt më 24 dhjetor të vitit të kaluar.**

Qëllimi i këtij takimi ishte që të potencohet angazhimi i mëtijshëm i BNJVL-së për mbështetjen e këtyre personave profesionalë dhe kontributin e tyre për forcimin e pjesëmarrjes qytetare në komunat, gjegjësisht të mundësohet, përmes shkëmbimit të ndërsjellë të përvojave, edhe më shumë t'i përsosin aftësitë e tyre për modelim, bashkërisht të përcaktojnë zgjidhje për tejkalimin e sfidave me të cilat përballen gjatë udhëheqjes së sesioneve, në drejtim të sigurimit të pjesëmarrjes më të madhe të popullatës në marrjen e vendimeve që janë me rëndësi për jetesën e përbashkët në bashkësinë lokale.

Të pranishmit u njoftuan edhe me aktivitetet e BNJVL-së në raport me koordinimin e mëtijshëm të moderatorëve ekzistues, por edhe për planet e ardhshme. U theksua edhe nevoja për përfshirje aktive në azhurnimin e vazhdueshëm të faqes së portalit të dedikuar për moderatorët, me plotësimin e profileve dhe me informacione për sesionet e

realizuara në komunat. Aktivitetet e BNJVL-së do të jenë edhe në drejtim të promovimit më të madh të këtij ueb-portali, ku është vendosur Regjistri i moderatorëve të certifikuar, si burim i vetëm i komunave për përzgjedhje në angazhimin e personave profesionalë për forumet. Të pranishmit u informuar se gjatë periudhës së ardhshme mendohet për një cikël të ri të trajnimeve për certifikimin e moderatorëve të ri.

Përvojat që i parashtruan të pranishmit në përqindje më të madhe kishin të bëjnë me sesionet e realizuara në realizimin e forumeve buxhetore në dhjetë komunat, që janë të mbështetura nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC). Ata flitnin për sfidat, me ç'rast shkëmbyen mes vete edhe propozime për tejkalimin më adekuat të tyre gjatë periudhës së ardhshme.

Përfaqësuesit e NJKF-së janë në përgjithësi të kënaqur nga mënyra në të cilën moderatorët e angazhuar i kanë realizuar forumet buxhetore

në 10 komunat. Ata potencuan se përgatitja e mirë, koordinimi me ekipin komunal dhe me bashkëmoderatorin janë elementet kryesore për sesione të suksesshme, të cilat gjithmonë duhet t'i kenë parasysh moderatorët. U konstatua se sukses më të madh mund të japin forumet “e përgatitura” sipas llojeve të caktuara të komunave, ndërsa u diskutua edhe për mundësinë për plotësimin e doracakut “Forume në bashkësinë në 11 hapa”. Takimet më të shpeshta të moderatorëve për shkëmbimin e përvojave dhe unifikimin e zbatimit të disa rregullave të caktuara, si dhe realizimi i vizitave të ndërsjella për ndjekjen e sesioneve ndërmjet moderatorëve dhe për bashkëmoderatorët, janë mundësi për përpërimin e gjithë procesit të “forume në bashkësinë”.

Në takimin, përveç moderatorëve, ishin të pranishëm edhe përfaqësues të Njësisë për Koordinimin e Forumeve (NJKF) dhe konsulentët, Boris Sharkovski dhe Dimçe Mitreski, si dhe përfaqësues të BNJVL-së.



## FORUMI U SHËRBEN NEVOJAVE TË QYTETARËVE

**Ambasadori i Zvicrës z. Stefano Lazaroto, më 5 dhjetor të vitit të kaluar, e përuroi në mënyrë solemne projektin në kuadër të programit “Forume në bashkësinë” në Komunën e Studeniçanit, që u realizua gjatë periudhës së viteve 2013/2014.**



Projektin “Rinovim dhe asfaltim të rrugës nr.2 në fshatin Studeniçan”, me vlerë prej rreth 7.600.000 denarë prej të cilave 2.400.000 denarë janë donacion i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC),

e zgjodhën banorët e komunës për prioritet në përmirësimin e jetesës së përditshme.

„Kam nderin që sot jam me ju dhe dua t’ju përgëzoj për zgjedhjen e këtij projekti, të cilin e realizuat së bashku me Ambasadën zvicerane.

Ky projekt jo vetëm që do t’u shërbejë nevojave të qytetarëve në këtë komunë, por edhe do të shërbejë për

ndërlidhjen e komunave tjera që janë afër rrugës së ndërtuar“, deklaroi ambasadori Lazaroto, në fjalimin para të pranishmëve. Ai iu falënderua kryetarit të Komunës së Studeniçanit z. Azem Sadiki që pranoi komuna të jetë e përfshirë në programin Forume në bashkësinë, si dhe bëri të ditur

se qëllimi i pjesëmarrjes së qytetarëve në forumet është transparenca më e madhe e komunës ndaj qytetarëve.

Kryetari i Komunës, Sadiki informoi se për ndërtimin dhe asfaltimin e rrugës



vendosën qytetarët përmes vendimeve të miratuara në sesionet e Forumeve në bashkësinë. “Këtë vendim e respektojmë deri në fund dhe kemi bërë gjithçka që ta realizojmë”, shtoi kryetari Sadiki.

Procesin e forumit në Komunën e Studeniçanit e realizoi organizata Asociacion për Iniciativa Demokratike (AID) nga Gostivari.

Cikli i tretë nga faza e tretë e programit “Forume në bashkësinë” u realizua në vitin 2013/2014 dhe përfshiu 11 komuna – Ilindenin, Shuto Orizarën, Krivogashtanin, Studeniçanin, Vinicën, Shtipin, Tetovën, Bërvenicën, Bogovinën, Makedonska Kamenicën dhe Dellçevën.

### TAKIM PËR RRJETËZIM NË STRUGË

## KOMUNAT SHKËMBYEN PËRVOJA NGA PROCESI BUXHETOR

**Përfaqësues të grupeve operative prej 10 komunave, duke përfshirë edhe koordinatoret komunalë dhe përfaqësuesit e sektorëve për financa dhe buxhet, pjesëmarrës në ciklin e ri të programit “Forume në bashkësinë”, ishin të pranishëm në takim për rrjetëzim që u mbajt më 20 dhe 21 shkurt, në hotelin “Drin”, në Strugë.**

Rreth 70 pjesëmarrës nga Ilinden, Studeniçani, Gostivari, Strumica, Mavrova dhe Rostusha, Kriva Pallanka, Radovishi, Kërçova, Kavadari dhe Novaci, shkëmbejnë përvoja nga proceset e forumit buxhetor që mbahen në komunat e tyre gjatë periudhës së viteve 2014/2015.

Takimi kishte për qëllim shkëmbimin e përvojave dhe praktikave të mira nga realizimi i 5 sesioneve nga



procesi i forumit buxhetor që këto komuna i realizojnë mëvetësishëm. U diskutua për specifikat e procesit të forumit, në pjesën e formës dhe përmbajtjes, si dhe mënyrës së udhëheqjes.

Në takimin ishin të pranishëm përfaqësuesit e grupeve operative në komunë, moderatorët dhe bashkëmoderatorët e proceseve të forumit, ekspertët dhe përfaqësuesit e Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC), të BNJVL-së dhe organizatorët (Njësia për Koordinimin e Forumeve).

# QYTETARËT PËR FORUMIN



## FORUMI ËSHTË PËRVOJË E SHKËLQYESHME PËR TË NJOFTUAR PROCESIN BUXHETOR

„Procesin e forumit buxhetor do ta vlerësoja si mundësi të jashtëzakonshme jo vetëm të njoftohemi se si shpenzohen paratë e komunës, por edhe të përfshihemi në vendimarrjen se si do të shpenzohen ato para sipas prioritetit. Kjo ishte përvojë e shkëlqyeshme praktike që nga afër të njoftohemi me procesin e buxhetimit, burimet e të ardhurave që derdhen në buxhetin komunal, shpenzimet sipas programeve dhe aktivitete projektuese, etj. Përsëritës edhe administratën komunale e cila tregoi transparencë dhe kishte durimin për t’i arsyetuar dhe sqaruar të gjitha propozimet tona, që do të thotë se është e gatshme

dhe dëshiron të bëjë dhe realizojë buxhet qytetar“, deklaroi Dimitar Petrovski, banor i Komunës së Kriva Pallankës.

## KOMUNA I PRANOI PROPOZIMET TONA

„Kishim propozime dhe shumica u pranuan. Propozuam që në Agllarcë të Epërme të bëhet një shteg për këmbësorë, të rindërtohet shkolla, si dhe të vendoset ndriçim në fshat. Të gjitha propozimet u pranuan“, deklaroi Anabella Petkovska, banore e Komunës së Novacit.

## QYTETARËT MË SË MIRI I DINË NEVOJAT

„Konsideroj se gjithë procesi i forumit ishte i organizuar dhe realizuar në mënyrë të shkëlqyer, dhe se qytetarët me të vërtetë

dhanë kontribut të madh në përcaktimin e programeve dhe projekteve më parësore nga buxheti komunal për vitin 2015. Askush nuk i di më mirë nevojat dhe problemet e qytetarëve, ndaj për këtë qëllim përcaktimi i tyre si prioritete duhet të merret parasysh gjatë miratimit dhe realizimit të buxhetit të komunës. Shpresoj se një pjesë e mirë e prioriteteve do të realizohen dhe të gjitha urimet për komunën që ka vendosur t’i përfshijë qytetarët në krijimin e programeve buxhetore“, deklaroi Natalija Millkovska, banore e Komunës së Kriva Pallankës.



Përgatitja e materialit: Njësia për koordinimin e forumeve në bashkëpunim me grupet operative nga të gjitha komunat  
Dizajni dhe vula: Arkus; Tirazhi: 330



Програма „Форуми во заедницата“  
Community Forums Programme  
Programmi „Forumet në bashkësi“



Schweizerische Eidgenossenschaft  
Confédération suisse  
Confederazione Svizzera  
Confederaziun svizra